



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 44 Datë 28.07.2011

MBI MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË
VARTËSISË PËR VITIN 2011

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë Korçë «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2011», në zbatim të ligjit nr 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", ligjit nr 9936 dt 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», Ligjit nr 10355 dt. 2.12.2010 " Për buxhetin e vitit 2011", VKM nr. 477 dt. 30.06.2010 "Për disa ndryshime në Vendimin nr 1114, dt. 30.07.2008 të Këshillit të Ministrave "Për disa çështje në zbatim të Ligjit 7703 dt. 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar" dhe të Ligjit 9136 dt. 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar dhe nr. 7870 dt. 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, V.K.M nr.693 datë 18.08.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619 dt. 02.07.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", VKM nr 929 dt.17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë ".Udhëzim nr 4 dt. 27.01.2011 i Ministrisë së Financave «Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011», Udhëzimi nr 37 dt. 20.11.2008 «Për përdorimin e të ardhurave nga procesi i legalizimit» si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë Buxhetin i Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2011.
2. Në zbatim të shkresës nr. 14882 datë 22.7.2011 të Ministrisë së Financave, të bëhet pakësimi i transfertës së pakushtëzuar në vlerën 5,173,000 lekë.
3. Të miratojë uljen e shpenzimeve në vlerën 5,173,000 lekë të detajuara si më poshtë :

Shpenzime operative	3,801,000 lekë
Fondi rezervë	372,000 lekë
Investime	1,000,000 lekë

4. Të miratojë planin e të ardhurave, transfertën e pakushtëzuar, dhe të ardhurat e trashëguara për vitin 2011 dhe përdorimin e tyre, në vlerën 700,148 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

Burimet e financimit:

-të ardhurat e trashëguara të vitit 2010	88,666 mijë lekë
-transferta e pakushtëzuar	167,287 mijë lekë
-të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	403,047 mijë lekë
-të ardhurat e institucioneve	17,372 mijë lekë
-huamarrja vendore	23,776 mijë lekë
Total	700,148 mijë lekë

5. Të miratojë planin e shpenzimeve sipas programeve për vitin 2011 gjithsej 700,148 mijë lekë ku përfshihen edhe detyrimet e vitit 2010 të detajuara si më poshtë :

Shpenzimet:

-administrim i përgjithshëm	206,919 mijë lekë
-shërbimet publike	306,881 mijë lekë
-arsimi parauniversitar	84,835 mijë lekë
-kulturë dhe sport	97,013 mijë lekë
-transporti urban	4,500 mijë lekë
Total	700,148 mijë lekë

6. Të miratojë normativat e harxhimit të: energjisë elektrike, të ujit, të telefonave fiks të instaluar në Bashki, të karburantit për makinat e Bashkisë, gjeneratorin dhe kaldajën, normativat e harxhimit të karburantit për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes, sipas tabelave të paraqitura në materialin e «Buxhetit të Bashkisë për vitin 2011».

7. Të miratojë përdorimin e telefonit celular të Kryetarit të përlogaritur sipas V.K.M 864 datë 23.07.2010 "Për paisjen me nr. Celular të personave juridikë, publikë" në vlerën 48 mijë lekë/vit.
8. Të miratojë përdorimin e 20% të transfertës së pakushtëzuar për shpenzimet (koston) e personelit administrativ në të cilën përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e administratës të njësisë së qeverisjes vendore sipas udhëzimit nr. 4 datë 27.01.2011 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011".
9. Të miratojë projektet e Bashkisë në vlerën 7,734,500 lekë sipas tabelave të paraqitura në materialin e buxhetit dhe menaxhimin e tyre nëpërmjet Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë si më poshtë :

PAKESOHET	00	01110 05	Art.6040000	- 5,834,500 lek
SHTOHET	00	01110 05	Art.6020000	+1,090,000 lek Bashkia
SHTOHET	00	09120 05	Art.6020000	+ 525,000 lek NSHMAC
SHTOHET	00	09120 05	Art.6060000	+ 945,000 lek NSHMAC
SHTOHET	00	08250 05	Art.6020000	+ 2,874,500 lek Q e Kulturës
SHTOHET	00	08140 05	Art.6020000	+400,000 lek KI Shumësportësh

10. Bazuar në ligjin 9376 dt. 21.04.2005 «Për Sportin», të miratohet trajtimi ushqimor për Klubin e Futbollit «Skënderbeu», për vitin 2011, si dhe për Klubin Shumësportësh «Skënderbeu».
11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet e Vartësisë.
12. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Kryetari

Ilirjan PENDAVINJI

P/ Ramonda Nare